



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE SHKODER
KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 1084/1 Prot.

Shkodër, më 15.11.2022

**SHPALLJE PËR LËVIZJEN PARALELE DHE PRANIMIN NË SHËRBIMIN CIVIL
GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE (SEKRETAR/E GJYËSOR/E)**

Në mbështetje të nenit 54, 55, 56, 57, 58, 60, 62, të Ligjit nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Udhëzimit nr.85, datë 11.03.2021 të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil gjyqësor, për kategorinë ekzekutive, për pozicionin:

1 (një) pozicion – sekretar/e gjyqësor/e, kategoria e pagës IV-a

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë gjyqësor të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se nga ky pozicion, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

LËVIZJE PARALELE:

30 Nëntor 2022

Afati për dorëzimin e dokumenteve për

PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR:

6 Dhjetor 2022

Përshkrimi përgjithshëm i punës për pozicionin sekretar/e gjyqësor/e është:





- a. Dokumenton për të gjitha efektet, në rastet dhe në mënyrat e parashikuara nga ligji, veprimtari të mirëfillta të gjykatës, të palëve e pjesëmarrësve të tjerë në process
- b. Merr pjesë në të gjitha veprimet e gjykatës për të cilat duhet të mbahet procesverbal.
- c. Mban procesverbalin e seancës gjyqësore në mënyrë elektronike dhe audio sipas programeve të implementuara në gjykatë, në përputhje me dispozitat procedurale në fuqi;
- d. Rregjistron çështjet, formon fashikujt gjyqësorë, duke futur atje dokumente ose kopje të tyre të vërtetuara sipas ligjit dhe shënon menjëherë datën e depozitimit, i ruan ato, përpilon komunikimet dhe njoftimet e parashikuara nga ligji ose nga gjykata dhe detyra të tjera që lidhen me procesin gjyqësor.
- e. Lëshon, kundrejt pagesës, kopje të akteve të përpiluara, të regjistrimeve të mbajtura me mjete të regjistrimit audio ose audiovizive, transkripte të plota ose të pjesshme të këtyre të fundit, si dhe ekstrakte autentike të akteve të përpiluara me shtypshkrim apo dorëshkrim.
- f. Është përgjegjës për krijimin e dosjeve dhe ndihmon gjyqtarin për mbajtjen e dosjeve sipas një rregulli të caktuar, si dhe për regjistrimin dhe zbatimin e urdhrave të shpallur apo të nxjerrë nga gjykatat dhe gjyqtarët;
- g. Ndihmon në mbajtjen e regjistrave, si dhe ndihmon në mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike atje ku këto janë të disponueshme;
- h. Ndihmon në çështje që lidhen me mbajtjen e dosjeve personale;
- i. Bashkëpunon me autoritetet kompetente për çështje të taksave dhe tarifave gjyqësore;
- j. Ndihmon në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kriterëve të përcaktuara për këtë qëllim dhe për saktësinë e të dhënave;
- k. Ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj, të autorizuar nga Kancelari dhe Kryetari i Gjykatës.

I. LËVIZJA PARALELE

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë gjyqësorë të së njëjtës kategori, në të gjitha gjykatat pjesë e shërbimit civil gjyqësor.

I.1. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të jetë nëpunës civil gjyqësor i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori për të cilën aplikon;
- b) të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c) të ketë të paktën vlerësimin e fundit "Mirë".

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- të jenë diplomuar në drejtësi të paktën në nivelin "Bachelor";
- b- të kenë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me gjykatën;

1.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dokumentet si më poshtë:

- a- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkurron;
- b- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në link-un e publikuar në faqen zyrtare të gjykatës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër “vende vakante”;
- c- Dokument që vërteton se kandidati ka fituar statusin e nëpunësit civil gjyqësor (vendim ose vërtetim nga Institucioni);
- d- Fotokopje (e noterizuar) të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- e- Fotokopje (e noterizuar) të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore sipas formularit tip që e gjeni në link-un e publikuar në faqen zyrtare të gjykatës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër “vende vakante”;
- i- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- j- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi ose të mos jetë në procedim disiplinor;
- k- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentet (në original apo kopje të njehsuar) duhet të dorëzohen me postë në adresën: Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër , Rr. “Don Bosko”, brenda datës 30.11.2022, ora 16.00.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në Gjykatë, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

1.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 02.12.2022, Kancelari i Gjykatës do të shpallë në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al dhe të Gjykatës www.gjykata.gov.al, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Këshilli i Gjykatës.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari individualisht, nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.

I.4. FUSHA E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

- a. Kodi i Procedurës Civile;
- b. Ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative";
- c. Kodi Pr. Administrative;
- d. Ligji nr.98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor";
- e. Ligji nr.152/2013 "Për nëpunësit civil", i ndryshuar;
- f. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat etike në administratën publike";

I.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a) 40 (dyzet) pikë për rezultatet e vlerësimit në punë.
- b) 50 (pesëdhjetë) pikë për vitet e përvojës profesionale në pozicionin përkatës si dhe vitet e përgjithshme të përvojës profesionale, në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e pozicionit përkatës, si dhe,
- c) 10 (dhjetë) pikë për trajnimet apo kualifikimet e lidhura në fushën përkatëse.

I.6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të KLGJ www.klgj.al, dhe të Gjykatës www.gjykata.gov.al.

II. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL GJYQËSOR NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Vetëm në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicion vakant, ky pozicion është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në faqen zyrtare të KLGJ, dhe të Gjykatës duke filluar nga data 02.12.2022.

Sipas nenit 55 të Ligjit 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil gjyqësor, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor janë:

- a – Të jetë shtetas shqiptar;
- b – Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c – Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d – Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e – Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f – Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil" i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a. të jenë diplomuar në drejtësi të paktën në nivelin "Bachelor";
- b. të ketë përvojë prej të paktën një vit të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me gjykatën;

II.2. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

- a. Kërkesë (e nënshkruar) motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron;
- b. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në link-un e publikuar në faqen zyrtare të gjykatës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër "vende vakante";
- c. Fotokopje (e noterizuar) të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor; për diplomat jashtë vendit, të përcillet njehsimi nga MAS);
- d. Fotokopje (e noterizuar) të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;



- g. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore sipas formularit tip që e gjeni në link-un e publikuar në faqen zyrtare të gjykatës, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër “vende vakante”;
- h. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- i. Vërtetim nga gjykata
- j. Vërtetim nga prokuroria

Dokumentet (në original apo kopje të njehsuar) duhet të dorëzohen me postë në adresën Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, Rr. “Don Bosko”, brenda datës **06.12.2022, ora 16.00**

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

II.3. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën **09.12.2022**, KLGJ do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe të Gjykatës listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kriteret e veçanta do të njoftohen nga Kancelari i gjykatës individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mail-it, për shkaqet e moskualifikimit.


Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten tek Kancelari i Gjykatës, brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

II.4. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI ME SHKRIM DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- a. Kodi i Procedurës Civile;
- b. Ligji nr. 49/2012, datë 03.05.2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”;
- c. Kodi Pr. Administrative
- d. Ligji nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”;
- e. Ligji nr.152/2013 “ Për nëpunësit civil”, i ndryshuar;
- f. Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat etike në administratën publike”;

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- 
- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
 - Eksperiencën e tyre të mëparshme;
 - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

II.5. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen:

- a. 60 (gjashtëdhjetë) pikë për vlerësimin me shkrim.
- b. 40 (dyzet) pikë për vlerësimin nga Këshilli.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, KLGJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në faqen e Gjykatës. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor për kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e KLGJ dhe të Gjykatës, për fazat e mëtejshme të procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor të kategorisë ekzekutive:

- Për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak.
- Datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Këshillit të Lartë Gjyqësor www.klgj.al dhe të Gjykatës www.gjykata.gov.al duke filluar nga data 09.12.2022.

KËSHILLI I GJYKATËS ADMINISTRATIVE TË SHKALLËS SË PARË SHKODËR

